


**PROGRAMI PËR
PROVIM**



**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT
SEKTORI I VLERËSIMIT TË TË ARRITURAVE TË NXËNËSVE**

GJUHË ANGLEZE

MATURA SHKETËRORE



Shkup, 2005

**ARSIMI I MESEM-
GJIMNAZ**

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT
SEKTORI I VLERËSIMIT TË TË ARRITURAVE TË NXËNËSVE

PROGRAMI PËR PROVIM

GJUHË ANGLEZE

MATURA SHTETËRORE
NË ARSIMIN GJIMNAZOR

Programi për provim nga **Gjuha angleze** për maturën shkollore në arsimin gjimnazor është sjellur me vendim të ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr.11-6815/3 më 10.11.2005.

1. HYRJE

Programi për provim është dokument i cili shkollave, arsimtarëve, nxënësve dhe të gjithë të tjerëve të interesuar për këtë provim ju ofron informata për përmbajtjen dhe aspektin cilësor të provimit.

Qëllimi i programit është:

- ta orientojë nxënësin me sukses të përgatitet për kalimin e provimit të maturës nga gjuha angleze si gjuhë e huaj;
- t'i ndihmojë arsimtarit për realizimin e suksesshëm të programit mësimor në funksion të përgatitjes së nxënësve për provimin e maturës.

Programi për provim bazohet në programet mësimore nga gjuha angleze për arsimin gjimnazor prej vitit të I^{re} deri në vitin e IV.

Objekti i kontrollimit të diturive dhe aftësive të nxënësve do të jenë pjesët e programit mësimor nga lënda e gjuhës angleze: **Të folurit, Të lexuarit, Të shkruarit dhe Kultura**. Pjesa e programit mësimor *Të dëgjuarit me kuptim* do të jetë përmbajtje e kontrollit atëherë kur në të gjitha shkollat e mesme në vendin tonë do të ketë kushte të barabarta materiale dhe të tjera të domosdoshme për një kontrollim të tillë.

Me këtë program për provim përcaktohet përmbajtja, organizimi dhe mënyra e aplikimit të maturës shtetërore në arsimin gjimnazor dhe efektet e parashikuara nga aplikimi i tij në përmirësimin e kualitetit të sistemit tonë arsimor.

Provimi nga gjuha angleze i cili aplikohet në fund të shkollimit katërvjeçar në arsimin gjimnazor do të mundësojë të kontrollojë:

- a ka përvetësuar nxënësi dituri dhe shkathtësi përkatëse nga gjuha angleze të cilat do ti mundësojnë me sukses ta rrumbullojë arsimimin e mesëm të tij;
- a është nxënësi i aftësuar që individualisht t'i zbatojë dituritë e përfituara nga gjuha angleze në kontekstin e përditshëm dhe profesional.

Ky provim do të jetë motivim që nxënësit në të ardhmen edhe më rrënjësisht ta mësojnë lëndën e gjuhës angleze.

Programi i provimit i përmban këto komponente:

- Qëllimi i përgjithshëm i provimit
- Përmbajtja e provimit
- Specifikimi i aftësive të cilat vlerësohen
- Konkretizimi i qëllimeve (diturive dhe aftësive)
- Rrjeti specifik i qëllimeve
- Përshkrimi i provimit
- Mënyra e vlerësimit.

2. QËLLIMI I PËRGJITHSHËM I PROVIMIT

Me këtë provim pritet që nxënësi të tregojë se është i aftë:

- Të komunikojë gojarisht duke i zbatuar modelet komunikative dhe elementet gjuhësore të parapara në programet mësimore të arsimit gjimnazor;
- Ta kuptojë të shkruarit dhe të mundet me shkrim të përgjigjet;
- Të komunikojë me shkrim duke i zbatuar modelet komunikative dhe elementet gjuhësore të parapara në programet mësimore për arsimin gjimnazor.

3. PËRMBAJTJA E PROVIMIT

1. Të folurit
2. Të lexuarit
3. Të shkruarit
4. Kultura*

* Përmbajtjet nga *Kultura* janë të përfaqësuara në detyrat e të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit në të cilat do të përfshihen konventat themelore dhe karakteristikat kulturore të vendeve ku flitet gjuha angleze – qëllimi sipas programit mësimor.

3.1. Dituritë dhe aftësitë të cilat vlerësohen

1. Të folurit
2. Të lexuarit
3. Të shkruarit
4. Kultura*

* Përmbajtjet nga *Kultura* janë të përfaqësuara në detyrat e të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit në të cilat do të përfshihen konventat themelore dhe karakteristikat kulturore të vendeve ku flitet gjuha angleze – qëllimi sipas programit mësimor.

3.2. Konkretizimi i qëllimeve

Në këtë pjesë janë dhënë qëllimet konkrete (dituritë dhe aftësitë) për përmbajtjet e programit të renditura në pjesë.

Pjesa 1: Të folurit

Nxënësi mund:

- të merr pjesë në komunikim me gojë;
- të shprehet gojarisht në temën e dhënë;
- të shprehë qëndrime personale, mendime dhe reaksione;
- të përdorë gjuhën formale dhe joformale në situatat e përditshme.

Temat dhe llojet e aktiviteteve për pjesën Të folurit

Temat	Llojet e aktiviteteve
<ul style="list-style-type: none">- Familja- Koha e lirë (intereset, hobit, udhëtimet, etj.)- Komunikimet bashkëkohore (shtypi, televizioni, Interneti etj.)- Muzika- Filmi- Sporti- Përditshmëria (shprehitë, zakonet, manifestimet)- Mjedi jetësor- Arsimi, profesionet, zanatet (planet për të ardhën dhe të ngjajshme)	<ul style="list-style-type: none">- Dhënia dhe kërkimi i informatave- Përshkrim i njerëzve, aktiviteteve, proceseve dhe vendeve- Luajtja e roleve (arsimtar-nxënës)- Shqiptimi sipas fotografive- Diskutim rreth një teme të caktuar

Pjesa 2: Të lexuarit dhe Të kuptuarit

Nxënësi:

- ta përcaktojë llojin e tekstit (artikull i gazetës, letër, shpallje etj.);
- të nxjerrë informata konkrete nga teksti;
- të përcaktojë / radhitë pjesë në strukturën e tekstit;
- të nxjerrë informata konkrete nga tabelat, grafikonet, dijagramet, hartat e dhënë, etj.
- të interpretojë fjalë dhe shprehje në kontekst të dhënë;
- ta kuptojë tekstin në përgjithësi;
- të nxjerr konkludime duke krahasuar më shumë tekste;
- të bëjë dalliminndërmjet mendimeve, qëndrimeve dhe fakteve në tekst.

Tema dhe lloje të teksteve për pjesën Të lexuarit dhe Të kuptuarit

Tema	Lloje të teksteve
<ul style="list-style-type: none">- Familja- Koha e lirë (intereset, hobit, udhëtimet, etj.)- Komunikimet bashkëkohore (shtypi, televizioni, Interneti etj.)- Mjedis jetësor- Muzika- Filmi- Sporti- Shprehitë, zakonet- Arsimi, profesionet, zanatet (planet për të ardhmen dhe të ngjajshme)	<ul style="list-style-type: none">- Artikuj nga gazetatat, letra, shpallje dhe të ngjajshme- Tekste aktuale për moshën dhe interesin e nxënësve

Pjesa 3: Të shkruarit

Nxënësi:

- të jep të dhënat personale;
- të shkruajë porosi të shkurtër;
- të shkruajë tekst formal/ joformal;
- të kërkojë/jep informata;
- të shkruajë hartim të shkurtër me temë të caktuar.

Tema dhe lloje të teksteve për pjesën Të shkruarit

Tema	Lloje të teksteve
<ul style="list-style-type: none">- Familja- Koha e lirë (intereset, hobit, udhëtimet, etj.)- Komunikimet bashkëkohore (shtypi, televizioni, Interneti etj.)- Mjedisi jetësor- Muzika- Filmi- Sporti- Përditshmëria (shprehitë, zakonet, manifestimet)- Mjedisi jetësor;- Arsimi, profesionet, zanatet (planet për të ardhmen dhe të ngjajshme)- Personalitete dhe ngjarje nga shkenca, letërsia dhe arti.	<ul style="list-style-type: none">- Biografi e shkurtër- Formularë- Letra joformale (për të shprehur informata personale, urime, falje, falënderime etj.)- Letra formale (falënderime, kërtime dhe dhënie të informatave, të shprehurit e pakënaqësisë, ankesa, të kërkuarit falje, vërtetime etj.)- Tekste aktuale për moshën dhe interesin e nxënësve- Tekste (përshkrime, shpjegime, të shprehurit mendime, qëndrime, libër ose film të shikuar, tekste gayetareske etj.)

4. SPECIFIKIMI (SKEMA) E QËLLIMEVE

Në skemat në vazhdim janë dhënë shkathtësitë të cilat do të jenë objekt i vlerësimit dhe llojet e aktiviteteve (Të folurit) dhe tekstet (Të lexuarit dhe Të shkruarit) të cilat korespondojnë me shkathtësitë e kërkuara (qëllimet).

Pjesa 1: Të folurit

Qëllimet	LLOJET E AKTIVITETEVE			
	Aktiviteti 1	Aktiviteti 2	Aktiviteti 3	Aktiviteti 4
<u>Qëllimi 1</u> Komunikim gojor	Kërkim dhe dhënie e informatave		Luajtja e roleve (arsimtar-nxënës)	Diskutim
<u>Qëllimi 2</u> Të shprehurit me gojë në temë të caktuar		Përshkrim i njerëzve, aktiviteteve, proceseve dhe vendeve		Diskutim
<u>Qëllimi 3</u> Të shprehurit e qëndrimeve personale, mendimeve dhe reagimet			Luajtja e roleve (arsimtar-nxënës)	Diskutim
<u>Qëllimi 4</u> Përdorimi i gjuhës formale dhe joformale në situata të përditshme	Kërkimi dhe dhënia e informatave		Luajtja në role (arsimtar-nxënës)	

Pjesa 2: Të lexuarit dhe Të kuptuarit

Llojet e teksteve	QËLLIMET							
	Qëllimi 1	Qëllimi 2	Qëllimi 3	Qëllimi 4	Qëllimi 5	Qëllimi 6	Qëllimi 7	Qëllimi 8
Artikull nga gazeta, letër, shpallje etj.	Përcaktim i llojit të tekstit		Përcaktim/renditje e pjesëve në strukturën e tekstit	Interpretim të fjalëve dhe shprehjeve në kontekst të dhënë	Kuptimi i përgjithshëm i tekstit	Të kuptuarit e tekstit në përghithësi	Nxjerrja e konkludimeve përmes krahasimeve të më shumë teksteve	Bërja e dallimit ndërmjet mendimeve, qëndrimeve, fakteve në tekst
Tekste aktuale për moshën dhe interesin e nxënësve		Nxjerrje të informatave konkrete nga teksti	Përcaktim/renditje e pjesëve në strukturën e tekstit	Interpretim të fjalëve dhe shprehjeve në kontekst të dhënë	Kuptimi i përgjithshëm i tekstit	Të kuptuarit e tekstit në përghithësi	Nxjerrja e konkludimeve përmes krahasimeve të më shumë teksteve	Bërja e dallimit ndërmjet mendimeve, qëndrimeve, fakteve në tekst
Tabela, grafikone, diagrame harta etj.		Nxjerrje të informatave konkrete nga teksti						

Pjesa Të exuarit dhe Të kuptuarit në provim përfaqësohet me 50%.

Pjesa 3: Të shkruarit

Llojet e teksteve	Q Ë L L I M E T				
	Qëllimi 1	Qëllimi 2	Qëllimi 3	Qëllimi 4	Qëllimi 5
Biografi e shkurtër (CV)	Dhënia e të dhënave personale				
Falënderim, urim, ftesë, të kërkuarit falje		Dhënia e të dhënave personale Të shkruhet porosi e shkurtër			
Letër formale/ joformale	Dhënia e të dhënave personale	Të shkruhet porosi e shkurtër	Të shkruhet tekst formal / joformal		
Plotësimi i formularit, lutjes, konkurrim	Dhënia e të dhënave personale			Kërkimi/dhënia e informatave	
Përshkrim, shpjegim, të shprehurit e mendimit			Të shkruhet tekst formal / joformal	Kërkimi/dhënia e informatave	Të shkruhet hartim i shkurtër me temë të caktuar

Pjesa **Të shkruarit** në provim përfaqësohet me 50%

5. PËSHKRIMI I PROVIMIT

Provimi i maturës nga lënda Gjuhë angleze përbëhet nga pjesa me gojë dhe me shkrim.

- Pjesa e parë e provimit përbëhet nga kontrolli me gojë i aftësive nga *Të folurit* në kohëzgjatjeje prej 10-15 minuta.
- Pjesa e dytë e provimit përbëhet nga kontrolli me shkrim i aftësive nga *Të lexuarit* në kohëzgjatjeje prej 90 minuta.
- Pjesa e tretë e provimit përbëhet nga kontrolli me shkrim i aftësive nga *Të shkruarit* në kohëzgjatjeje prej 90 minuta.

Për pjesën *Të folurit*, provimi do të mbahet në mënyrë interne, nga ana e komisioneve shkollore të lëndës.

Për pjesët *Të Lexuarit* dhe *Të Shkruarit*, provimi do të mbahet në mënyrë interne, në një sesion pa pushim, me material të përgatitur në mënyrë interne.

Provimi do të përmbajë:

- a) dy detyra për *Të folurit*;
- b) disa detyra për *Të lexuarit* të cilat do të përfshijnë gjithsejt 50 pyetje;
- c) dy detyra për *Të shkruarit*.

Llojet e detyrave të provimit

Pjesa 1: Të folurit

Llojet e detyrave të dhëna në vazhdim për kontrollimin e aftësisë të folurit janë të përshtatura me temat e parapara në programin e provimit.

Detyrat do të jenë të llojit:

- Dhënie dhe kërkim i informative;
- Përshkrim i njerëzve, aktiviteteve, proceseve dhe vendeve;
- Loja me role (arsimtar-nxënës);
- Naracioni i fotografive
- Diskutim rreth një teme të caktuar;

Pjesa 2: Të lexuarit dhe Të kuptuarit

Llojet e detyrave të dhëna në vazhdim bazohen në disa tekste, tabela, grafikone, diagrame, harta, etj. të marrura prej burimeve të ndryshme.

Detyrat do të jenë të llojit:

- Pyetje me zgjedhje të shumëfishtë;
- Plotësim i fjalëve dhe frazave të lëshuara;
- Radhitje e paragrafeve sipas renditjes logjike;
- Lidhje të fjalëve me përshkrime përkatëse;
- Përcaktim i saktësisë së shprehjes. (T/F)

Pjesa 3: Të Shkruarit

Pjesa *Të shkruarit* testohet nëpërmjet zgjedhjes së detyrave me të cilat do të përfshihen të gjitha qëllimet e parapara. Detyrat e provimit do të dallohen për nga numri i fjalëve dhe nga kërkesat specifike të cilat rrjedhin nga lloji i detyrës.

Për shembull:

- prej 80 deri 100 fjalë:
 - të shkruarit e porosisë së shkurtër;
- prej 100 deri 120 fjalë:
 - tekst formal ose joformal;
- prej 140 deri 180 fjalë:
 - hartim me temë caktuar.

6. MËNYRA E VLERËSIMIT

Pjesa 1: Të folurit

Pjesa e *Të folurit* do të kontrollohet përmes dy detyrave. Njëra i takon llojit të të shprehurit individual gojor dhe tjetra llojit të komunikimit interaktiv.

- Detyrat e llojit të të shprehurit individual gojor përfshijnë : përshkrim të njerëzve, aktiviteteve, proceseve dhe vendeve.
- Detyrat e llojit të komunikimit interaktiv me kontrolluesin (anëtarin e komisionit) përfshijnë: kërkim dhe dhënie të informatave, loja me role dhe diskutim në temë të caktuar.

Çdo detyrë vlerësohet me numrin e mundshëm të pikëve **20**. Numri i mundshëm i pikëve për pjesën *Të lexuarit* është **40**. **Nxënësi e kalon provimin në pjesën *Të folurit* nëse fiton minimum 20 pikë.**

Për shembull:

- | | |
|--|----------------------------|
| 1. Përshkrim i njerëzve, aktiviteteve, proceseve dhe vendeve | 20 pikë të mundshme |
| 2. Kërkim dhe dhënie të informatave | 20 pikë të mundshme |

Vlerësimi i detyrave të provimit nga komponenti *Të folurit* do të kryhet me ndihmën e **kriteriumeve në vazhdim me të cilat përshkruhen 4 nivele të kërkesave të arritura:**

- **Leksiku**
- **Gramatika**
- **Rrjedhshmëri gjatë të folurit dhe interakcion**
- **Shqiptimi**
- **Koherenca**

- **Leksiku**

- 3 Leksiku është i pasur, i shumëllojshëm dhe drejt i përdorur (nivelet e kërkesave të arritura).
- 2 Leksiku është i pasur, por nuk është në harmoni dhe ka gabime gjatë përdorimit të shprehjeve më të ndërlikuara.
- 1 Leksiku është i kufizuar, por mundëson të shprehurit e shprehjeve themelore.
- 0 Leksiku është shumë i kufizuar me një numër të madh të fjalëve gabimisht të përdorura, fjalët nuk i përkasin detyrës së parashtruar.

- **Gramatika**

- 3 Janë përdorur struktura gramatikore përkatëse dhe të shumëllojshme me gabime të parëndësishme.
- 2 Përdorim i drejtë i strukturave gramatikore, me gabime gjatë përdorimit të strukturave më të ndërlikuara.
- 1 Janë përdorur struktura gramatikore të thjeshta, me gabime sistematike, por shprehja prap mund të kuptohet.
- 0 Nuk i zotëron strukturat themelore gramatikore që sjell deri te moskuptimi i mjaftueshëm i shprehjes.

- **Rrjedhshmëria gjatë të folurit dhe interaksioni**

- 3 Shprehet rrjedhshëm dhe merr pjesë aktive në komunikim.
- 2 Shprehet rrjedhshëm, por me ndërprerje të herëpashërëshme, a interaksioni është në nivel të kënaqshëm.
- 1 Mungon rrjedhshmëria gjatë të shprehurit dhe tregon kufizim në komunikim për shkak të pamundësisë të kuptojë.
- 0 Të shprehurit është shumë i kufizuar, e niveli i interaksionit është i pakënaqshëm.

- **Shqiptimi**

- 3 Shqiptimi është i drejtë me gabime të parëndësishme të theksit, ritmit dhe intonacionit.
- 2 Shqiptimi është i drejtë herë-herë me gabime në theks, ritëm dhe intonacion.
- 1 Gjatë të shqiptuarit paraqitet një numër i madh i gabimeve të cilat e vështirësojnë komunikimin.
- 0 Gjatë të shqiptuarit paraqitet numër më i madh i gabimeve të cilat e pamundësojnë komunikimin.

- **Koherenca**

- 3 Mund të zhvillojë bisedë të lidhur, duke përdorur në mënyrë të plotë dhe adekuate zgjedhje të madhe të llojeve të lidhëseve dhe shprehje të tjera lidhore.
- 2 Mund të zhvillojë bisedë të qartë dhe mirë të strukturuar, duke përdorur zgjedhje adekuate të llojeve të lidhësive dhe shprehje tjera lidhore.
- 1 Mund të përdorë numër të kufizuar të lidhësive dhe shprehjeve lidhore në të folurit e qartë dhe të lidhur.
- 0 Mund të zhvillojë bisedë të paqartë me përdorimin e lidhësive të thjeshta sikur që janë „dhe”, „mirëpo”...

		Leksiku	Gramatika	Rrjedhshmëria gjatë të folurit dhe interakcioni	Shqiptimi	Koherenca
Shkëlqyeshëm	3	(4 pikë) Leksiku është i pasur, i shumëllojshëm dhe saktë i përdorur.	(4 pikë) Janë përdorur strukturat përkatëse gramatikore dhe të shumëllojshme me gabime të parëndësishme.	(4 pikë) Shprehet rrjedhshëm dhe merr pjesë aktive në komunikim	(4 pikë) Shqiptimi është i drejtë me gabime të parëndësishme të theksit, ritmit dhe intonacionit.	(4 pikë) Mund të zhvillojë bisedë të lidhur, duke përdorur në mënyrë të plotë dhe adekuate zgjedhje të madhe të llojeve të lidhëseve dhe shprehje të tjera lidhore.
Mirë	2	(3 pikë) Leksiku është i pasur, por nuk është në harmoni dhe ka gabime gjatë përdorimit të shprehjeve më të ndërlikuara.	(3 pikë) Përdorim i drejtë i strukturave gramatikore, me gabime gjatë përdorimit të strukturave më të ndërlikuara.	(3 pikë) Shprehet rrjedhshëm, por me ndërprerje të herëpashërshme, e interakcioni është në nivel të kënaqshëm.	(3 pikë) Shqiptimi është i drejtë herë-herë me gabime në theks, ritëm dhe intonacion.	(3 pikë) Mund të zhvillojë bisedë të qartë dhe mirë të strukturuar, duke përdorur zgjedhje adekuate të llojeve të lidhësive dhe shprehje tjera lidhore.
Kënaq	1	(2 pikë) Leksiku është i kufizuar, por mundëson të shprehurit e shprehjeve themelore	(2 pikë) Janë përdorur strukturat e thjeshta gramatikore, me gabime sistematike, por shprehja prap mund të kuptohet	(2 pikë) Mungon rrjedhshmëria gjatë të shprehurit dhe tregon kufizim në komunikim për shkak të pamundësisë të kuptojë.	(2 pikë) Gjatë të shqiptuarit paraqitet një numër i madh i gabimeve të cilat e vështirësojnë komunikimin.	(2 pikë) Mund të përdorë numër të kufizuar të lidhësive dhe shprehjeve lidhore në të folurit e qartë dhe të lidhur.
Nuk kënaq	0	(1 pikë) Leksiku është shumë i kufizuar me një numër të madh të fjalëve gabimisht të përdorura, fjalët nuk i përkasin detyrës së	(1 pikë) Nuk i zotëron strukturat themelore gramatikore që sjell deri te moskuptimi i mjaftueshëm i	(1 pikë) Të shprehurit është shumë i kufizuar dhe niveli i interaksionit është i pakënaqshëm.	(1 pikë) Gjatë të shqiptuarit paraqitet numër më i madh i gabimeve të cilat e pamundësojnë komunikimin.	(1 pikë) Mund të zhvillojë bisedë, mjaft të paqartë me përdorimin e lidhësive të thjeshta sikur që janë „dhe”, „mirëpo”...

	parashtruar.	shprehjes.			
--	--------------	------------	--	--	--

Pjesa 2: Të lexuarit dhe Të kuptuarit

Pjesa *Të lexuarit dhe Të kuptuarit* do të testohet nëpërmjet pesëdhjetë pyetjeve të shpërndara në numër të ndryshëm të detyrave varësisht prej numrit të dhënë të teksteve dhe të ngjashme.

Pyetjet do të jenë të llojit të pyetjeve me zgjedhje të shumëfishtë, plotësim të fjalëve ose frazave të lëshuara, radhitje në paragrafe sipas rendit logjik, lidhje reciproke të fjalëve me përshkrime adekuate, përcaktim i saktësisë së thënies.

Çdo përgjigje e saktë vlerësohet me një pikë. Numri i mundshëm i pikëve për pjesën *Të lexuarit* është **50 pikë**.

Pjesa 3: Të shkruarit

Pjesa *Të shkruarit* do të testohet nëpërmjet dy detyrave të provimit nga zgjedhja e më poshtme me të cilat do të përfshihen të gjitha qëllimet e parapara. Detyrat e provimit do të dallohen sipas numrit të fjalëve dhe sipas kërkesave specifike që rrjedhin nga lloji i detyrës.

Për çdo detyrë të provimit numri i mundshëm i pikëve është **25**. Numri i mundshëm i pikëve për pjesën *Të shkruarit* është **50**.

Për shembull:

- prej 80 deri në 100 fjalë: pikë të mundshme **25**
 - të shkruajë porosi të shkurtër;
- prej 100 deri në 120 fjalë: pikë të mundshme **25**
 - letër formale dhe joformale;
- prej 140 deri në 180 fjalë pikë të mundshme **25**
 - hartim me temë të caktuar.

Vlerësimi i detyrave të provimit nga komponenti *Të shkruarit* do të mbahet me ndihmën e **kriteriumeve në vijim me të cilat përshkruhen katër nivele të kërkesave të arritura:**

- **Drejtshkrimi**
- **Leksiku**
- **Strukturat gramatikore**
- **Struktura**
- **Përmbajtje adekuate**

- **Drejtshkrimi** (nivelet e kërkesave të arritura)

- 3** Ka gabime të parëndësishme në të shkruarit e fjalëve dhe në interpunksion të cilat nuk pengojnë të kuptuarit e tekstit.
- 2** Hasen gabime në të shkruarit dhe në interpunksion të cilat mund ta pengojnë të kuptuarit e tekstit.
- 1** Ka më shumë gabime në të shkruarit e fjalëve dhe në interpunksion të cilat pengojnë të kuptuarit e tekstit.
- 0** Numër i madh gabimesh në të shkruarit e fjalëve dhe në interpunksion të cilat e pamundësojnë të kuptuarit e tekstit.

- **Leksiku**

- 3** Leksiku është i pasur, i shumëllojshëm dhe saktë i përdorur.
- 2** Leksiku është i pasur, por nuk është në harmoni dhe ka gabime gjatë përdorimit të shprehjeve më të ndërlikuara.
- 1** Leksiku është i kufizuar, por mundëson të shprehurit e shprehjeve themelore.
- 0** Leksiku është shumë i kufizuar, me një numër të madh të fjalëve gabimisht të përdorura, fjalët nuk i përkasin detyrës së parashtruar.

- **Strukturat gramatikore**

- 3 Janë përdorur strukturat gramatikore përkatëse dhe të shumëllojshme me gabime të parëndësishme.
- 2 Përdorim i drejtë i strukturave gramatikore, me gabime gjatë përdorimit të strukturave më të ndërlikuara.
- 1 Janë përdorur struktura të thjeshta gramatikore , me gabime sistematike, por teksti përsëri mund të kuptohet.
- 0 Kandidati nuk i zotëron strukturat themelore gramatikore që sjell deri te moskuptimi i mjaftueshëm i tekstit

- **Struktura**

- 3 Organizim i qartë dhe i dallueshëm si dhe strukturë adekuate për detyrën e dhënë. Idetë janë radhitur logjikisht me pasuse të renditura drejt. Janë përdorur mjete lidhshmërie të shumëllojshme.
- 2 Struktura i përgjigjet detyrës së dhënë. I është kushtuar kujdes i pamjaftueshëm lidhshmërisë logjike të ideve në tekst si dhe përdorimit të mjeteve adekuate të lidhshmërisë.
- 1 Teksti ka strukturë të paqartë. Nuk ka pasuse të ndara dhe ka përdorim të kufizuar ose joadekuat të mjeteve të lidhshmërisë.
- 0 Teksti nuk ka organizim dhe strukturë.

- **Përmbajtja adekuate (nivelet e kërkesave të arritura)**

- 3 Përmbajtja është adekuate dhe plotësisht i përgjigjet kërkesave të detyrës së dhënë nga aspekti gjuhësor dhe kulturor. Idetë janë të qarta dhe në tekst hasen shembuj adekuat. Në tekst ka elemente të kreativitetit.
- 2 Përmbajtja i përgjigjet kërkesave të detyrës së dhënë, mirëpo vërehen njohuri të pamjaftueshme të konventave kulturore. Idetë janë të qarta edhe pse hasen informata joadekuate.
- 1 Përmbajtja pjesërisht i përgjigjet kërkesave të detyrës. Idetë përsëriten dhe teksti përmban informata të panevojshme.
- 0 Përgjegjja është plotësisht jo adekuate me detyrën e dhënë.

	Drejtshkrimi	Leksiku	Strukturat gramatikore	Struktura	Përmbajtje adekuate
3	(5 pikë) Ka gabime të parëndësishme gjatë të shkruarit të fjalëve dhe interpunkcionit. - tekst prej 60-80 fjalë me 3 gabime - tekst prej 80-100 fjalë me 5 gabime - tekst prej 120-150 fjalë me 7 gabime.	(5 pikë) Leksiku është i pasur, i shumëllojshëm dhe saktë i përdorur.	(5 pikë) Janë përdorur strukturat gramatikore përkatëse dhe të shumëllojshme me gabime të parëndësishme.	(5 pikë) Organizim i qartë dhe i dallueshëm si dhe strukturë adekuate për detyrën e dhënë. Idetë janë radhitur logjikisht me pasuse të renditura drejt. Janë përdorur mjete lidhshmërie të shumëllojshme dhe adekuate.	(5 pikë) Përmbajtja është adekuate dhe plotësisht i përgjigjet kërkesave të detyrës së dhënë nga aspekti gjuhësor dhe kulturor. Idetë janë të qarta dhe në tekst hasen informata adekuate me elemente të origjinalitetit.
2	(4 pikë) Hasen gabime në të shkruarit dhe në interpunkcion të cilat nuk e pengojnë të kuptuarit e mendimit. - tekst prej 60-80 fjalë me 5 gabime - tekst prej 80-100 fjalë me 7 gabime - tekst prej 120-150 fjalë me 9 gabime	(4 pikë) Leksiku është i pasur, por nuk është në harmoni dhe ka gabime gjatë përdorimit të shprehjeve më të ndërlikuara	(4 pikë) Përdorim i drejtë i strukturave gramatikore, me gabime gjatë përdorimit të strukturave më të ndërlikuara.	(4 pikë) Struktura i përgjigjet detyrës së dhënë. I është kushtuar kujdes i pamjaftueshëm lidhshmërisë logjike të ideve në tekst si dhe përdorimit të mjeteve adekuate të lidhshmërisë.	(4 pikë) Përmbajtja i përgjigjet kërkesave të detyrës së dhënë, mirëpo vërehen njohuri të pamjaftueshme të konventave kulturore. Idetë janë të qarta me numër të pamjaftueshëm të informatave.
1	(3 pikë) Më shumë gabime në të shkruarit e fjalëve dhe në interpunkcion të cilat e pengojnë të kuptuarit e mendimit. - tekst prej 60-80 fjalë me mbi 5 gabime - tekst prej 80-100 fjalë me mbi 7 gabime - tekst prej 120-150 fjalë me mbi 9 gabime.	(3 pikë) Leksiku është i kufizuar, por mundëson të shprehurit e shprehjeve themelore	(3 pikë) Janë përdorur struktura të thjeshta gramatikore , me gabime,	(3 pikë) Teksti ka strukturë dhe kompozicion joadekuat me përdorim të kufizuar të mjeteve të lidhshmërisë.	(3 pikë) Përmbajtja pjesërisht i përgjigjet kërkesave të detyrës. Idetë përsëriten dhe teksti përmban informata të panevojshme.

0	(2 pikë) Numër i madh gabimesh në të shkruarit e fjalëve dhe interpunkcion të cilat e pamundësojnë të kuptuarit e tekstit.	(2 pikë) Leksiku është shumë i kufizuar, me një numër të madh të fjalëve gabimisht të përdorura, fjalët nuk i përkasin detyrës së parashtruar.	(2 pikë) Janë përdorur strukturat themelore gramatikore me gabime elementare.	(2 pikë) Teksti ka strukturë të paqartë, nuk ka pasuse të ndara dhe ka përdorim të lidhëseve në mënyrë jo adekuate.	(2 pikë) Përmbajtja në përgjithësi nuk u përgjigjet kërkesave të detyrës. Idetë janë të paqarta dhe teksti përmban informata joadekuate.
---	---	---	--	--	---

Kriteret plotësuese

1. Për secilin lloj të detyrës lejohet maksimum tolerancë prej 10 fjalëve (mbi apo nën numrin e kërkuar të fjalëve).
fitohen zero (0) pikë.
2. Gjithçka që është mbi apo nën pragun e lejuar të tolerancës fitohen me 0 pikë për përmbajtjen edhe pse ajo nuk i përket kërkesës së detyrës.
3. Në qoftë se nxënësi ka shkruar 50% më pak ose më shumë nga numri i kërkuar të fjalëve, në pajtim me llojin e detyrave, teksti vlerësohet me 0 pikë sipas të gjitha kriterëve.
- 4.. Gabimet që përsëriten në drejtshkrim nuk numërohen.